



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, Datë 09.09.2015

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN “NDËRTIMI I FABRIKËS SË PASURIMIT TË KROMIT”, ME VENDNDODHJE NË KALIMASH, BASHKIA KUKËS”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin “Ndërtimi i Fabrikës së Pasurimit të Kromit”, me vendndodhje në Kalimash, Bashkia Kukës”, me subjekt kërkues shoqërinë konçensionare “EUROCHROME” sh.p.k.
2. Kusht për miratimin e Lejes së Ndërtimit është pajisja me vendimin e Këshillit të Basenit Ujor për përdorimin e rezervës ujore.
3. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
  - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
5. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore.
6. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE EKKT**

**EGLANTINA GJERMI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**DAMIAN GJIKNURI**

**MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

*Adelina Greca*



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**